

Republika e Shqipërisë
Dhoma e Noterëve Tiranë
Notere Anisa G. Dizdari
Nr. 1883 Rep.
Nr. 596/3 Kol.



Taksa e Pullës
U PAGUA

KONTRATË SHITJE-BLERJE KUOTASH

Sot më datë 07/12/2018 (Dymijë e tetëmbëdhjetë) në Tiranë para meje Notere **Anisa G. Dizdari**, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me Liçensë Nr.238, me NI PT L31925014A, që ushtrij aktivitetin në studion e ndodhur në adresën Rr. "Dibrës", Nr.277, Tiranë u paraqitën personalisht palët si mëposhtë:

Shitësi: Eduard Meta, i biri i Eqeremit, lindur në Tiranë, i datëlindjes 30.10.1979, banues në Tiranë, në adresën Rr. "Sitki Çiço", shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr.Pasaporte BG39362620 dhe Nr.Personal H91030038A, me cilësinë e ortakut të Shoqërisë "IGOR ELEKTRIK" sh.p.k., regjistruar pranë QKB-së me dt.22.01.2016, me NIPT L61322023P, e cila në këtë kontratë do të cilësohet si pala shitëse.

Blerësi: Muhamet Petriti, i biri i Ganiut, lindur në Shkozë, ALB, i datëlindjes 14.06.1957, banues në Tiranë, në adresën Shkozë, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Nr.Letërnjoftimi 032716674 dhe Nr.Personal F70614033H, me cilësinë e ortakut të Shoqërisë "IGOR ELEKTRIK" sh.p.k., regjistruar pranë QKB-së me dt.22.01.2016, me NIPT L61322023P, i cili në këtë kontratë do të cilësohet si pala blerëse.

Kushte të përgjithshme:

Shoqëria "IGOR ELEKTRIK" sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar me dt.22.01.2016, me NIPT L61322023P, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Gjin Bue Shpata", hyrja 1, kati 5, me aktivitet në fushën e studimit, projektimit, supervizionit dhe ndërtimin e linjave elektrike mbitokësore, (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energjinë elektrike (linja fuqie) dhe telekomunikacioni etj. në përputhje me legjislacionin në fuqi, sipas përcaktimeve të Ekstraktit të Regjistrit Tregtar lëshuar nga QKB.

Palët kanë rënë dakord paraprakisht për kalimin e titullit të pronësisë mbi kuotën dhe kapitalin e shoqërisë sipas përcaktimeve që do të bëhen në këtë kontratë shit-blerje kuotash, referuar edhe Vendimit të Ortakut të Shoqërisë "IGOR ELEKTRIK" sh.p.k., dt.05.12.2018 për masën dhe mënyrën e kalimit të kuotave palës blerëse.

Për sa mësipër dhe bazuar edhe në nenin 73 të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar nga Ligji Nr.129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9901, dt.14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë të ndryshuar", palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 – Blerja e kuotave në shitje

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate në datën e nënshkrimit të saj, pala shitëse i shet palës blerëse dhe pala blerëse do të blejë nga pala shitëse, një kuotë të shoqërisë sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:

Shitësi Eduard Meta do t'i shesë blerësit dhe blerësi Muhamet Petriti do të blejë një kuotë nga shitësi i kuotës, me vlerë nominale prej 25,00 (njëzetë e pesë) Lekë, që përfaqësojnë 25% të

kapitalit të shoqërisë dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo Barrë, me çmimin e blerjes dhe të pagueshme sipas mënyrës që përcaktohet po aty.

Neni 2 – Çmimi i blerjes dhe mënyra e pagesës

Çmimi total i blerjes së kuotave në shitje është 25.00 (njëzetë e pesë) Lekë, shumë e cila është likujduar totalisht jashtë kësaj Zyre Noteriale.

Neni 3 – Deklarimet dhe garancitë

Pala shitëse me anë të kësaj kontrate deklarohet dhe garanton në lidhje me shoqërinë si dhe me transaksionin që parashikohet në këtë kontratë.

Pala shitëse deklarohet dhe garanton se shoqëria është krijuar dhe themeluar sipas legjislacionit shqiptar, nuk është në gjendje paaftësie paguese apo në falimentim.

Pala shitëse deklarohet se janë ndjekur rregullisht, të gjitha aktet ligjore dhe /ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të shitësit dhe që autorizojnë shitësin të lidh dhe të zbatojë këtë kontratë.

Neni 4 - Pronësia

Pala shitëse është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i kuotave që përbëjnë 25% të kapitalin themeltar të shoqërisë.

Kuotat në shitje janë të lira nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar apo transferuar dhe dorëzuar kuotat në shitje në përputhje me afatet e kontratës.

Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje apo detyrim që krijon apo vendos barrë në lidhje me kuotat në shitje ose ndonjë numër kuotash të autorizuara, por të paemtuara në kapitalin e shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka të drejtë mbi ndonjë barrë të mundshme të lidhur, me kuotat që janë në shitje.

Neni 5 – Mënyra e kalimit të pronësisë së kuotave

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala shitëse e humbet të drejtën e pronësisë mbi kuotën e saj (pra një kuotë) të kapitalit me vlerë 25.00 (njëzetë e pesë) Lekë, e cila korrespondon me 25% të kapitali të shoqërisë.

Ortaku i shoqërisë **Eduard Meta** humbet pronësinë në masën 25% (njëzetë e pesë përqind), të kuotës të zotëruar prej tij, e cila korrespondon me 25% të kapitalin themeltar të shoqërisë **"IGOR ELEKTRIK" sh.p.k.**, duke kaluar të drejtën e pronësisë blerësit, ortakut **Muhamet Petriti**, i cili bëhet ortak i vetëm në masën 100% (njëqind përqind) të titullit të pronësisë të kuotave të shitura nga ortakut tjetër, që përfaqëson vlerën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.

Shoqëria tregtare **"IGOR ELEKTRIK" sh.p.k.** pas realizimit të këtij transaksioni shit-blerje kuotash do të ketë si ortakë të vetëm të saj:

1. Muhamet Petriti, i cili zotëron kuotat në vlerën 100.00 (njëqind) Lekë, me pjesëmarrje në përqindje në vlerën 100% të kapitalit themeltar, me një kuotë.

2. Nestor Muhametllari, mbetet administrator dhe përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Neni 6 – Premtime të përbashkëta të palëve

Palët do t'i sigurojnë njëri-tjetrit çdo dhe gjithë informacionin e nevojshëm për përfundimin e këtij procesi.

Neni 7 – Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8 – Të ndryshme

8.1 Ndryshimet

Çdo korigjim, ndryshim, zgjidhje apo heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj kontrate do të jetë e vlefshme vetëm në qoftë se bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose për llogari të secilës palë.

8.2 Vlefshmëria e pavarur nga njëra- tjetra e dispozitave kontraktore

Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket ose çenohet nga një fakt i tillë.

Palët pranojnë se do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pavlefshme ose të pazbatueshme në masën më të madhe të mundshme, për të përmbushur qëllimin e kësaj dispozite.

8.3 Njoftimet

Njoftimet ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë (Njoftimi) do të jenë:

- Me shkrim
- Në gjuhën shqipe
- Do të dorëzohen ose dërgohen me postë të shpejtë me kthim përgjigje ose faks, palës që duhet të marrë njoftimin në adresën e caktuar nga pala përkatëse.

Me përjashtim të rastit kur provohet se njoftimi është marrë më shpejt, njoftimi do të quhet i dhënë nëse:

- Është dërguar me postë, 10 dite pune, pas postimit të tij
- Është dërguar me faks, kur konfirmimi i dërgimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

8.4. Kalimi i të drejtave

Kjo kontratë është detyrim ligjor dhe në përfitim të palëve, trashëgimtarëve të tyre dhe personave, të cilëve u kalojnë këto të drejta.

Bleresi nuk mund të kalojë dhe transferojë të drejtat e tij sipas kësaj kontrate, plotësisht apo pjesërisht, pa miratimin paraprak me shkrim të shitësit, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

8.5. Kostot dhe taksat

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, secila palë do të paguajë shpenzimet e saj në lidhje me negocimin, hartimin, nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate dhe të shtojcave të saj (nëse do të ketë). Të gjitha shpenzimet noteriale për nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të paguhen nga pala blerëse.

8.6. Tërësia e kontratës

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve që lidhet me objektin e kësaj kontrate.

Palët kishin rënë dakord paraprakisht për lidhjen e kësaj kontrate, unë Noteria, redaktova vullnetin e tyre në pesë kopje të njëjta, në gjuhën shqipe dhe pasi palët e lexuan atë, e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruan në prezencën time dhe unë Noteria e vërtetoj atë sipas ligjit.

Shitësi

Eduard Meksi

Blerësi

Muhomet Petri

**NOTERE
ANISA G. DIZDARI**

Anisa G. Dizdari



Shoqëria "IGOR ELEKTRIK"
NIPT L61322023P
Rr. "Gjin Bue Shpata", hyrja 1, kati 5



VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Nr. 11, dt. 05.12.2018

Shoqëria e regjistruar në Regjistrin Tregtar me dt.21.01.2016 me objekt në fushën e studimit, projektimit, supervizionit dhe ndërtimin e linjave elektrike mbitokësore, (ajrore) dhe nëntokësore (kabllore) për energjinë elektrike (linja fuqie) dhe telekomunikacioni etj. ka kapitalin e nënshkruar 100,00 Lekë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e përfaqësuar nga Eduard Meta dhe Muhamet Petriti, e mbledhur sot më dt.05.12.2018 në selinë e saj mori vendimin si më poshtë vijon:

1. Ortaku Eduard Meta t'i shesë Muhamet Petritit 25 pjesë të kalitalit me vlerë nominale 25.00 Lekë secila, në total njëzetë e pesë Lekë.
2. Administrator i shoqërisë dhe përfaqësuesi ligjor do të jetë Nestor Muhametllari.
3. Ngarkohen punonjësit e shoqërisë "IGOR ELEKTRIK" sh.p.k. të kryejnë veprimet konform vendimit të marrë për depozimin e vendimit në regjistrin e vendimeve të shoqërisë dhe depozitimim e vendimit në QKB.

Asambleja e Përgjithshme

Ortakët

Eduard Meta

Muhamet Petriti







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L61322023P
2. Data e Regjistrimit	22/01/2016
3. Emri i Subjektit	IGOR ELEKTRIK
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	21/01/2016
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/01/2016
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Gjin Bue Shpata", hyrja 1, kati 5
8. Kapitali	100,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	<p>Veprimtari private ne fushen e studimit, projektimit, supervizionit dhe ndertimin e linjave elektrike mbitokesore, (ajrore) dhe nentokesore (kabllore) per energjine elektrike (linja fuqie) dhe telekomunikacioni (nenstacione elektrike te larte) dhe tensioni te mesem (kabinat elektrike), Punime elektrike, murature, konstruksione metalike. Ne fushen e ndertimit te objekteve civile, industriale dhe social kulturore. Ne fushen e ndertimit te rrjeteve inxhinierike te ujesjellesit, te kanalizimeve te ujrave te zeza, te vaditjes dhe kullimit. Ne fushen e ndertimit te rrugeve, urave, hekurudhave . Import eksport, tregti me shumice e pakice te artikujve industriale, elektrike, hidraulike dhe ndertimi". Tregtimin me shumice e pakice te materialeve te ndryshme te ndertimit, qeramike dhe hidrosanitare, hidrotermoizoluese, pllaka per shtrim veshjesh, shitblerje e objekteve te ndertimit, punime duralumini e punime pllaka gipsi etj. Shitblerje me shumice e pakice, eksport import te mallrave te ndryshem industrial, ushqimor, bar bufe, konfeksione, tekstile, paisje elektroshtepiake, artikuj mobilerie dhe mobilime zytrash,</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	artikuj kancelarie, karta telefonike.	
10. Administratori/ët	Nestor Muhametllari	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 22/06/2018	Deri: 22/06/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	EduardMeta	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 25,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	25,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Ortakët	MuhametPetriti	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 75,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	75,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Vaqarr PRUSH Njesia Administrative Vaqarr, Qender Prush, Zona Kadastrale 3064 me nr.pasurie 295/2, si magazine	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: IGOR ELEKTRIK E-Mail: igorelektrik@hotmail.com Telefon: 0682042555	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 07/12/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)